



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

### Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06 - 14041 /25

Klinë, dt: 12 - 05 /25

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 07.04.2025, me fillim nga ora 09:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti drejtorët, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, OSBE-në, Policinë e Kosovës dhe gjithë të pranishmit.

Kryesuesi, prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2025 (ref, Drejt.Fin.);
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve të mbetur nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025 ( ref. nga EKZ.);
5. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të kryetarit të komunës për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.06-8532/2025 (ref. nga EKZ);
6. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.553-8606/2025 dhe 01Nr.553-8607/2025 (ref. nga DKA);
7. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimit 01Nr.644-8473/25 ( ref. nga DKRS);
8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt mars-prill 2025;
9. Të ndryshme.

**Fadil Gashi, kryesues:** Materialin e keni marrë të gjithë, më duket. Prezent jemi të gjithë, prandaj konstatoj se mund të vazhdojmë mbledhjen e Komitetit. Unë po hap debat për rend të

ditës. A ka dikush për rend të ditës? Nëse s'ka, kush është për ?

**Me 7 vota PËR u miratua rendi i ditës.**

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Jemi të gjithë të pranishëm.

**Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Kush është për miratim të këtij procesi?

**Me 7 vota PËR, u miratua procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Pika 3. Shqyrtimi i raportit të menaxhimit financiar janar-mars 2025 (ref. Drejt.Fin.).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Fjalën ia kaloj drejtorit për Financa, z. Enver Berisha.

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Faleminderit, kryesues. Përshëndetje për anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa! Realisht, ky është prezantimi i parë për tremujorin e këtij viti, por duke u bazuar në planifikimin që ne kemi bërë bashkërisht në dëgjime buxhetore, po edhe me kryetarin e ekzekutivit, po ashtu me votimin që është bërë në Asamblenë Komunale për buxhetin e vitit 2025, dmth në total ky buxhet është 16,238,141.93 euro, e që ky buxhet është i përbërë prej grandit qeveritar me 14,673,000.00 euro, të hyrat vetanake janë 1,495,000.00, grandi i donatorëve të brendshëm është 48,572.00 euro, grandi i donatorëve të jashtëm është 18,814.00 euro, dhe grandi i jashtëm i performances është 2,575.00.

Karshi këtyre, dmth shpenzimet e tyre i keni nëpër tabelat që janë bërë nëpër kategori të caktuara, dmth në komunal, në subvencione, në kapitale, dhe ju e keni parë që kësaj here është një trend jashtëzakonisht i mirë i shpenzimeve që ndoshta i tejkalon përmasat e tremujorit të parë. Por, ky tremujor i kësaj here është realisht me shpenzime më të mira edhe besoj që i keni të gjithë nëpër tabela aty, po unë po i prezantoj:

Në grandin qeveritar janë shpenzuar 29.74% , të hyrat vetanake janë shpenzuar 11.17% , në grandin qeveritar të donatorëve 24.30% dhe kështu që, në total dmth është bërë shpenzimi i këtij tremujori është 27.98% , do të thotë që është në performancën më të mirë që ka mundur të ndodh shpenzimi për këtë tremujor. Unë më tepër nuk isha lëshuar, pasi të gjitha të dhënët dhe projektet janë të paraqitura në tabelat që i keni përparrë. Faleminderit, kryesues!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, drejtor. Nëse ka dikush?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të Raportit të Menaxhimit Financiar janar-mars 2025, me 7 vota PËR, rekomandoi që Raporti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.**

**Pika 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartje të mjeteve të mbeturat nga të hyrat vetanake të vitit 2024 në vitin 2025 ( ref. nga EKZ).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Urdhëro, drejtor.

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Po besoj që tabelaren e keni marr të gjithë, mirëpo në vija të trasha po e prezantoj edhe njëherë. Këtu bëhet fjalë për grantin e performancave dhe të hyrave vetanake që janë realizuar më tepër sesa planifikimi që ka qenë për vitin 2024. Në total vlera e kësaj bartje është 624,854.00 euro, dmth është një vlerë bukur e mirë. Kryesuesi e di, këtu ka qenë një pjesë e mirë e planifikuar që ne kemi menduar me qenë për shujtat e punëtorëve, por realisht kjo ka dështuar dhe vazhdojmë me procedura tjera. Në kuadër të këtij grandi ose të hyrave vetanake ne kemi menduar që mallra dhe shërbime me i ndarë 90,000.00 shtesë për shkak të obligimeve që po na dalin më shumë për këtë vit; shpenzimet komunale, po ashtu 90,000.00 euro; në subvencione dhe transfere 92,746.95 dhe; në shpenzime kapitale 352,000.00.

Dmth, këto janë të shpërndara nëpër projekte qysh i keni parë edhe ju, por nëse ka diçka konkrete për secilën pjesë veç e veç, mund ta sqaroj më shumë. Faleminderit!

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, drejtor. A ka dikush? Tunë Deda.

**Tunë Deda:** Faleminderit, pëershëndetje për ju, kryesues, pëershëndetje për gjithë! Drejtor, faleminderit shumë, po diçka që nuk më pëlqej mua dhe që është shumë e dhimbshme, mosrealizimi i shujtave për punëtorët. Kjo, nuk e di, pse ekziston Kuvendi nëse vendimet e tij nuk mund të zbatohen. Nëse vendimi nuk zbatohet, atëherë për çfarë e kemi Kuvendin? Le të vendosë ministria atje. Ky është mendimi im personal.

**Fadil Gashi, kryesues:** Ne, po më duket e kemi konsumuar si temë edhe në seancë, kështu që, nuk varet nga niveli lokal. Është nga niveli qendror, nga Ministria e Financave dhe punëve të brendshme, deri në Ministri të Linjës. Ata na kanë kthyer përgjigje, ju e dini. Ne s'kemi lëvizur tash prej vendimi, ne prapë kemi qëndruar në vendim. E tha edhe drejtori, se tash e ka rrugën tjetër administrative vendimi edhe besoj që ai vendim duhet patjetër të implementohet.

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Kryesues, karshi kësaj, unë dua t'ua bëj juve me dije si Komitet për Politikë dhe Financa se çka po ndodh mes nivelit lokal dhe atij qendror. Ne, për çdo vit nënshkruajmë kontratë me Postën për shpërndarje të faturave për tatimin në pronë. A e di çka ka ndodhur tash në këtë vit? Insistimi i tyre ka qenë që me nënshkruar kontratën sa më herët, dhe unë, qysh në fillim të janarit, e kam nënshkruar kontratën me kusht që ta zëmë hapin sa më shpejt dhe t'juu dërgojmë faturat e tatimit në pronë qytetarëve. Ende, Ministria nuk ja kanë lëshuar faturat për postën, dmth deri në fund të këtij muaji e ka afatin kësti i parë edhe ata nuk i lëshojnë faturat për ta ekzekutuar pagesën e këstít të parë. Nuk di çka po ndodh me ne kështu, por shpresoj që të zgjidhet sa më parë!

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush? Nëse s'ka, a mund ta rekomandojmë për Kuvend?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për bartje e mjeteve te pashpenzuara dhe mjetet nga tejkalimi i planit të të hyrave vetanake për vitin 2024, dhe bartjen në vitin 2025, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 5. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të kryetarit të komunës për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.06-8532/2025 (ref. nga EKZ).**

Propozim-vendimi **01Nr.06-8532/2025**, propozim i dhënë nga Kryetari i Komunës, bazuar në kërkesën e Bashkësisë Islame në Klinë me anë të së cilës kërkojnë financim në vlerë prej **15,000.00** euro për blerjen e një vture e cila do të shërbente për shërbime të cilat kryhen nga BIK.

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Kryesues, kemi pasur biseda edhe me kryetarin, dhe po ashtu kryetari ka biseduar me udhëheqësit e Bashkësisë Islame në Klinë. Kjo ka të bëjë me bashkësinë Islame, që ka dakordimin tonë. Mendoj se është e arsyeshme që kjo çështje të shkojë në Kuvend.

**Tunë Deda:** Po, kryesues, unë pajtohem dhe mendoj se është shumë e mirë. Ne si grup e përkrahim këtë iniciativë. Është mirë që shuma e kërkuar nga ata të ndahet në Kuvend. Faleminderit.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për ndarje të mjeteve për blerjen e një vture për shërbimet e Bashkësisë Islame në Klinë, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

Propozim-vendimi 01Nr.06-8705/2025, propozim i dhënë nga Kryetari i Komunës, bazuar në kërkesën e Stacionit Policor në Klinë, me anë të së cilës propozohet ndarja e shumës në vlerë prej 11,000.00 euro me qëllim të plotësimit të nevojave dhe krijimit të kushteve më të mira të Policisë së Kosovës, Stacionit Policor në Klinë.

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush? Po, Tunë Deda.

**Tunë Deda:** Unë jam për ta përkrahur, por mendoj se është dashur Ministria ta kryejë këtë punë.

**Fadil Gashi, kryesues:** Ky stacion nuk ofron asnjë shërbim për qeverinë, për ministritë, ose për

Prishtinën, por vetëm për komunën e Klinës dhe qytetarët tanë. Nëse ne kemi mundësi, duhet t'i ndihmojmë realisht vetës, në kuptimin e cilësisë së shërbimit. Nuk ka asgjë negative në këtë ndihmë, madje kemi pasur pengesa të tjera, pasi niveli qendror ka shumë stacione dhe kërkesa për mbulim të nevojave në komuna të tjera. Ndonjëherë këto stacionet si Kлина na mbèsin mënjanë, sepse nuk mund të mbulohen të gjitha nevojat. Po ashtu, ju e dini që kemi kontribuar edhe me mjetet tona për t'i shërbyer qytetarëve, duke i ofruar disa herë automjetet tona për shkak të mungesës së mjeteve.

**Tunë Deda:** Unë jam për t'i ndarë mjetet, por thash në atë aspektin që Ministria duhej t'i kryente këto punë. Ata kanë nevojë, dhe ne duhet të sjellim një vendim për ta dërguar në Kuvend dhe t'u ndajmë shumën që ata e kërkojnë, sepse kjo është për të mirën e qytetarëve. Thash edhe në aspektin që Ministria nuk duhet të lë barrën mbi komunat, ashtu siç e ka bërë me shujtat për mësimdhënësit, që na morën në qafë.

**Fadil Gashi, kryesues:** Po, pajtohem, por megjithatë, jemi të vullnetit të mirë për t'i ndihmuar. Kjo është e rëndësishme. A ka dikush tjetër? Kush është për?

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrimit të propozim-vendimit për ndarje të mjeteve në shumë prej 11,000.00 euro, me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**Pika 6. Shqyrtimi i propozim-vendimeve të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimeve 01Nr.553-8606/2025 dhe 01Nr.553-8607/2025 (ref. nga DKA).**

**Fadil Gashi, kryesues:** Fjalën e ka zyrtari i Arsimit, z.Astrit Muhaxheraj.

**Astrit Muhaxheraj, zyrtar i DKA-së:** Mirëmëngjesi gjithëve, faleminderit, kryesues, përshëndetje për të gjithë! Ashtu siç keni mundur ta shihni, sipas mendimit tonë profesional që e kemi marr si drejtori për dy raste, i kemi dy nxënëse, njëra në shkollën fillore "Ismet Rraci"- Klejda Bashota, dhe tjetra është në shkollën e mesme "Luigj Gurakuqi"-Tuana Camaj. Te rasti i parë, kërkesën e ka adresuar edhe prindi, edhe shkolla, për në Drejtoren e Arsimit për mbështetje financiare. Kemi një ftesë për pjesëmarrje në festival në Gjermani, ku kërkesa edhe e Tuanës edhe e shkollës është brenda një shume të caktuar, vlera 2500 euro. Ndërsa sipas anës sonë si Drejtori, kemi propozuar që kjo shumë të mbulohet me 1500 euro për të dy rastet. Po ashtu, te rasti i nxënëses Tuana Camaj, kërkesa është për pjesëmarrje në një olimpiadë shkencore në Spanjë, edhe kjo e ka shumën e caktuar më duket 2550 euro. Ne kemi propozuar që për të dy nxënëset të ndahet një shumë prej 1500 euro. Të dyja nxënëset janë të njohura për ne dhe kanë treguar sukses në shumë gara lokale, shtetërore dhe ndërkombëtare. Ju mbetet juve që të procedoni më tutje.

**Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit, megjithëse kërkesat ishin për 2 500 euro, ne do të shikojmë kërkesën e tyre dhe tuajën. Urdhëro, Asdren.

**Asdren Ramadani:** Përvendetje për të gjithë! Po, edhe ne e përkrahim këtë vendim, sepse është vendim i qëlluar. Ja vlen t'i përkrahim nxënësit që kanë vullnet dhe janë të talentuar, për të përfaqësuar Kosovën dhe komunën tonë. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për ata, dhe na përfaqësojnë edhe neve.

**Tunë Deda:** Edhe ne e përkrahim, por shuma nuk është e mjaftueshme 1 500 euro, por së paku të ishte 2 000 euro, sepse ata me siguri që kanë shumë shpenzime të tjera për këtë udhëtim. Shuma prej 2 500 euro është planifikuar për të mbuluar të gjitha shpenzimet, duke përfshirë biletën e udhëtitimit, shujtat, drekët dhe darkën. Ne propozojmë që të ndahen 2 000 euro për secilin nxënës dhe ta çojmë këtë në Kuvend për miratim. Sipas kërkesës së tyre, pjesëmarrja është pa përfshirë këto shpenzime, dhe ne mund të kontribuojmë duke mbuluar shumat që janë të nevojshme.

**Astrit Muhamheraj, zyrtar i DKA-së:** Ne kemi kalkuluar një shumë që kemi supozuar në atë që është më e mbuluar prej anës së komunës. Sigurisht se për ne është edhe më mirë në qoftë se mbulohen shpenzimet që i kanë kërkuar palët.

**Tunë Deda:** Faleminderit për mundimin që keni bërë për të ulur shumat, por nëse pjesëmarrja është 2 550 euro, duhet që Kuvendi ta mbulojë plotësisht këtë shumë. Nëse nxënësit nuk mund ta mbulojnë vetë këtë shumë, ata mund të mos kenë mundësi të marrin pjesë, dhe kjo nuk është e drejtë. Jam për të mbuluar plotësisht shumat për pjesëmarrje dhe duhet të gëzohemi, të bëhem krenarë që kemi kështu nxënës të shkëlqyer që na përfaqësojnë.

**Astrit Muhamheraj, zyrtar i DKA-së:** Bashkëngjitur është edhe kërkesa e palëve, kështu që, prej anës tonë është veç si mendim profesional. Tash me ndihmën e asaj që me qenë më e aluduar prej anës së Kuvendit Komunal, përndryshtë nëse arrin të mbulohet shuma e përgjithshme që ka kërkuar, ajo është veç edhe më e pranueshme për gjithë.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të DKA-së për ndarje të mjeteve financiare për nxënëset Klejda Bashota dhe Tuana Camaj, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, po ashtu në bazë të mundësive buxhetore të rritet vlera e rekomanduar nga DKA.**

## **7. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare sipas propozimit 01Nr.644-8473/25 ( ref. nga DKRS).**

Propozim-vendimi 01Nr.644-8473/25 i dhënë nga DKRS për ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 30,000.00 euro nga kategoria e subvencioneve në DKRS për mbajtjen e edicionit të 23 të festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë”.

**Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit të DKRS-së për ndarje të mjeteve financiare për mbajtjen e festivalit folklorik “I Këndojmë Lirisë” me 7 vota PËR, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

**8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt mars-prill 2025.**

**Fadil Gashi, kryesues:** Nuk kemi më kërkesa.

**Pika 9. Të ndryshme.**

**Fadil Gashi, kryesues:** A ka dikush në të ndryshme? Atëherë, po ju falënderoj shumë për pjesëmarrje dhe angazhim!

Procesmbajtësja,  
Monika Palushi



**KRYESUESI,**  
**Fadil Gashi**